

Investimet në Spitalin e Vlorës



Investimi për rehabilitimin dhe fuqizimin e shërbimit të Dispancerisë dhe Farmacisë në Spitalin Rajonal Vlorës është një investim i buxhetit të shtetit, që garanton ofrimin e shërbimeve moderne, me standarde evropiane dhe me pajisje të teknologjisë së fundit në fushën e farmaceutikës dhe radiologjisë. Një tjetër investim që është duke u kryer aktualisht në këtë spital, një projekt ambicioz që synon të vendosë një standard bashkëkohor për qytetarët është dhe fuqizimi dhe modernizimi i shërbimit të urgjencës. Përfundimi i zbatimit të këtij projekti përkon me fillimin e sezonit turistik ku Spitali i Vlorës, si spitali më i madh për rajonin e jugut është një pikë referimi jo vetëm për vizitorët e bashkisë Vlorë por edhe të bashkive Sarandë dhe Himarë.



HAPET LABORATORI I RI I ANATOMISË PATOLOGJIKE NË QSUT

Laboratori i ri i Anatomisë Patologjike në QSUT do t'i shërbejë rreth 15 mijë pacientëve në vit dhe do të jetë një laborator bërthamë për të gjithë shërbimin e Anatomisë Patologjike në vend. Ky investim është pjesë e investimit për modernizimin e rrjetit të laboratorëve publikë në vend dhe rritjes së gamës së analizave që ofrohen falas për qytetarët, me të njëjtin standard në çdo spital. Vetëm përgjatë vitit 2022, janë më shumë se 500 mijë pacientë të shërbyer në spitalet publike, në sistemin me shtretër, në sistemin ambulator dhe në shërbimet e urgjencës, të cilët kanë kryer me cilësi dhe standarde evropiane analizat laboratorike.

PROGRAMI I RI I MBËSHTETJES PËR NËNAT ME SHUMË FËMIJË

Programi më i ri i mbrojtjes sociale për grupet më në nevojë është mbështetja e veçantë për gratë e papuna me 3 apo më shumë fëmijë deri 18 vjeç, me të ardhura familjare deri në 100 mijë lekë në muaj, me pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, për periudhën e kujdesit ndaj fëmijës deri 5 vjeç. Aplikimet kryhen në platformën e-Albania.



INVESTIMI NË QENDRËN KOMBËTARE TË TRANSFUZIONIT TË GJAKUT

Transformimi i qendrës së dhurimit dhe bankës të gjakut me pajisje të teknologjisë së lartë, rikonstruksioni i plotë i godinës, riorganizimi i shërbimeve, janë të parashikuara në investimin në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, që pritet të përfundojë brenda këtij viti. Ndërhyrjet në godinë do të mundësojnë ngritjen e një qendre dinjitoze dhe bashkëkohore të cilësisë së lartë, e cila do të plotësohet me shërbimet laboratorike, të përpunimit dhe menaxhimit të bankës së gjakut, sipas standarde evropiane.

PUNËSOHEN MBI 950 INFIERMIERË

Gjatë vitit 2022, nëpërmjet portalit "Infermierë për Shqipërinë" janë punësuar mbi 950 infermierë e teknikë të shkencave mjekësore në strukturat e kujdesit shëndetësor publik. Janë rreth 2 mijë teknikë të shkencave mjekësore, infermierë, fizioterapistë, laborantë, të cilët kanë aplikuar në portalin "Infermierë për Shqipërinë" për vitin 2023. Për mbështetjen e vazhdueshme ndaj mjekëve dhe infermierëve edhe për vitin 2023 është planifikuar rritje pagash për personelin shëndetësor në 7%, duke filluar që nga muaji korrik.

